



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL Anr.264/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik, Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, e parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komuna Prishtinë, për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN të pa bazuara ankesat ZL. Anr.264/2025, dhe ZL. Anr.265/2025 të datës 18.10.2025, të parashtruara nga subjekti politik, Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Prishtinë, për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2025, PZAP-i, ka pranuar dy ankesa nga subjekti politik Lëvizjes Vetëvendosje me numër protokolli ZL. Anr.264/2025, ZL. Anr.265/2025.

-Në ankesën ZL. Anr.264/2025 theksohet se më 16.10.2025 rreth orës 18:00, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje! në Prishtinë, kanë vërejtur se: gjatë procesit të numrit të votave në QKN Prishtinë të Zgjedhjeve Lokale për Kryetar të Komunës së Prishtinës, të mbajtura më 12 tetor 2025, fletëvotimi nga vendvotimi 1913/06 është shpallur i pavlefshëm nga komisionerët përkatës përkundër faktit se: fletëvotimi është plotësuar në përputhje me nenin 16 paragrafi 5 i Rregullores Zgjedhore 12/24, votuesi ka votuar vetëm një kandidat për kryetar të komunës dhe atë kandidatin që përfaqëson subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje! Nga vrojtimi i fletëvotimit mund të kuptohet qartë vullneti i votuesit sepse i njeiti në brendësi të katrorit të fletëvotimit ka vendosur shenjë tik tek subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje dhe kandidati i saj për kryetar të Komunës së Prishtinës. Si dëshmi kanë bashkangjitur: foton e fletëvotimit.

Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë nga PZAP që të urdhëroj KQZ që fletëvotimin nga vendvotimi 1913/06 ta vlerësoj si të vlefshëm dhe ta përfshijë në rezultatin zgjedhor.

-Në ankesën ZL. Anr.265/2025 theksohet më 17.10.2025 rreth orës 17:30, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje! në Prishtinë, kanë vërejtur se: gjatë procesit të numrit të votave në QKN Prishtinë të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendin Komunal të Komunës së Prishtinës, të mbajtura më 12 tetor 2025, fletëvotimi nga vendvotimi 1917/02 është shpallur i pavlefshëm nga komisionerët përkatës përkundër faktit se: fletëvotimi është plotësuar në përputhje me nenin 16 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore 12/24, votuesi ka votuar vetëm një subjektin politik dhe atë Lëvizjen Vetëvendosje!

Nga vrojtimi i fletëvotimit mund të kuptohet qartë vullneti i votuesit sepse i njëjti tek emri i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dhe atë dy herë ka vendosur shenjë tik. Si dëshmi kanë bashkangjitur: foton e fletëvotimit.

Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë nga PZAP që të urdhëroj KQZ që fletëvotimin nga vendvotimi 1917/02 ta vlerësoj si të vlefshëm dhe ta përfshijë në rezultatin zgjedhor.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, theksohet se bazuar në nenin 3, paragrafi 1,38 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) është institucioni përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente, në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar. Po ashtu, sipas nenit 5, paragrafi 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 Qendra Komunale e Numërimit, ndër funksionet e QKN përfshihet edhe numërimi i fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike. Në lidhje me vlefshmërinë e fletëvotimeve, neni 16, paragrafi 5 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcakton se një votë është e vlefshme atëherë kur votuesi e ka shënjuar vetëm një kandidat në fletëvotim. Në të kundërtën, vota konsiderohet e pavlefshme nëse: votohet më shumë se një kandidat për kryetar; nuk votohet asnjë kandidat; qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim. Për më tepër, sipas nenit 16, paragrafi 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024, nëse anëtarët e KVV nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është vota e vlefshme apo i pavlefshme, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkitazi me atë votë dhe këto rast e evidenton në librin e votimit. Në doracakun për procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotim, të miratuar nga KQZ me dt. 12.08.2025, nr. 01/2051-2025, parashihen shembujt e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme për kuvendet komunale dhe për kryetar të komunave. (Shih të bashkangjitur procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotim). Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.A.nr.264/2025 dhe ZL.A.nr.265/2025 të datës 18.10.2025, të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë të përbashkët ZL.A.nr.264/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:
Ankesat janë të pa bazuara.

Paneli vlerësoi se janë të pabazuara pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendon se në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Prishtinë, gjatë procesit të numërimit të votave, ka vërejtur se një fletëvotim nga Vendvotimi me numër 1913/06 dhe një fletëvotim nga Vendvotimi me numër 1917/02, janë shpallur të pavlefshme nga komisionerët përkatës. Pasi që nga fotot e bashkangjitura si provë në ankesën ZL Anr 264/2025 shihet se në fletëvotim, njëri tik është i vendosur në katrorin e numrit 105 Lëvizja Vetëvendosje Hajrulla Çeko, ndërsa tiku tjetër është vendosur tek numri 113 Lidhja Demokratike e Kosovës Përparim Rama, ndërsa nga fotot e bashkangjitura si provë në ankesën ZL Anr 265/2025 shihet se në fletëvotim, njëri tik është i vendosur tek numrit 105 Lëvizja Vetëvendosje Mrika Limani Myrtaj, ndërsa tiku tjetër është vendosur tek numri 111 Fatmir Selimi, dhe qëllimi i votuesve nuk është i kuartë, andaj nga shikimi i këtyre fotove shihet se këto fletëvotime janë të pavlefshme pasi që nuk mund të konsiderohet se është votuar vetëm subjekti politik LVV, dhe kandidatët e saj për të cilën pretendon pala me ankesë.

Në Nenin 16 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, në zgjedhjet për Kuvendin e Komunës në mënyrë decisive thuhet se *“vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit”* Ndërsa në nenin 16 par.2.2 të të njëjtës Rregullore vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur : *Kur votohet më shumë se një subjekt politik; kur nuk votohet asnjë subjekt politik; kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik; kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.* Ndërsa në paragrafin 5 të të njëjtës rregullore thuhet se në zgjedhjet për Kryetar të Komunës *“vota e vlefshme konsiderohet, atëherë kur votuesi e ka shënuar vetëm një kandidat në fletëvotim dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit”* Ndërsa vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur: *Kur votohet më shumë se një kandidat për kryetar; kur nuk votohet asnjë kandidat; kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.*

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e tij pasi që nga provat e ofruara si dëshmi shihet kuartë se fletëvotimet në fjalë nuk janë plotësuar sipas rregullave të votimit si dhe sipas dispozitave të sipërcituara dhe mbi këtë bazë këto fletëvotime duhet të shpallen të pavlefshme.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të plotë se pretendimet ankimore janë të pa bazuara në ligj, andaj ankesa u refuzua e pa bazuar në kuptim të nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe mbi këtë arsye paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL. Anr.264/2025, datë 20.10.2025

Kryesues i Panelit,

Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.